



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 102/4 prot.

Tiranë, më 13.3.2025

V E N D I M

Nr.7, datë 13.3.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË
GJATË PROCEDURËS SË NDJEKUR PËR PLOTËSIMIN E POZICIONIT TË
PUNËS DREJTOR I PËRGJITHSHËM NË AUTORITETIN PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT (AIDSSH)**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të informacionit të regjistruar pranë Komisionerit me nr. 102 prot., datë 30.1.2025, të dërguar nga nëpunësi *Selami Zalli*,

VËREJ SE:

Në përmbajtjen e informacionit të dërguar nga punonjësi *Selami Zalli*, janë ngritur pretendime për parregullsi të lejuara në administrimin e shërbimit civil gjatë zhvillimit të procesit të emërimit të nëpunës *E. Shtino*, në pozicionin e punës “Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Trajtimit të Kërkesave”, nëpërmjet aktit nr. 1887/3 prot., datë 30.12.2024, të Sekretarit të Përgjithshëm, “Rikthim në shërbimin civil dhe fillimin e marrëdhënieve të punës dhe marrëdhënieve financiare”, në institucionin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), duke arsyetuar se ky pozicion pune, edhe pse ka qenë vakant për një periudhë relativisht të gjatë kohore, nuk është shpallur për tu plotësuar përmes procedurës së konkurrimit.

Pasi u njoh me rrethanat e parashtruara në këtë informacion, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 152/2013, i ndryshuar, Komisioneri ka

filluar kryesisht procesin e verifikimit të veprimeve administrative, të kryera gjatë procedurës së plotësimit të pozicionit të punës “Drejtor i Përgjithshëm”, në institucionin në fjalë. Për këtë fakt, nëpërmjet shkresës nr. 102/1 prot., datë 6.2.2025, “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin paraprak të informacionit të administruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 102 prot., datë 30.1.2025”, është informuar institucioni i Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, duke i kërkuar edhe dokumentacionin përkatës në lidhje me këtë procedurë.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 280/1 prot., datë 11.02.2025, me objekt: “Dërgim dokumentacioni”, protokolluar pranë Komisionerit me shkresën nr. 102/2 prot., datë 12.2.2025, institucioni ka sqaruar situatën dhe njëkohësisht ka dërguar dokumentacionin shoqërues, ku përfshihet, ndër të tjera: struktura e institucionit në të cilën evidentohet pozicioni i punës objekt verifikimi; aktet në të cilat materializohet procedura e pezullimit nga shërbimi civil në pozicionin e mëparshëm të punës, që mbante punonjësja E. Shtino në këtë institucion në momentin e pezullimit dhe aktet që vërtetojnë procedurën e emërimit të saj në pozicionin aktual të punës.

Nga analiza e rrethanave të çështjes dhe e gjithë dokumentacionit të administruar pranë Komisionerit, rezulton se, pozicioni i punës “Drejtor i Përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Trajtimit të Kërkesave”, në institucionin e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) është i parashikuar në strukturën aktuale të institucionit, e cila është miratuar me Vendimin nr.19/2023, datë 16.03.2023, të Kuvendit të Shqipërisë, i ndryshuar.

Konstatohet se, nga ana e institucionit është miratuar dhe publikuar plani i rekrutimit për vitin 2024, në përputhje me kërkesat e nenit 18, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pozicioni i punës objekt verifikimi, rezulton se është i përfshirë në përmbajtjen e tij.

Në përgjigje të sqarimeve të kërkuara nga Komisioneri, në lidhje me faktin se përse ky pozicion pune nuk është publikuar më parë, nga ana e institucionit është argumentuar se ai ka qenë dhe vazhdon të jetë pjesë e një procesi të gjerë konsultimi, me organet drejtuese të Autoritetit, për shkak të nevojës së një riorganizimi brenda strukturës ekzistuese të institucionit, për ndarjen e funksioneve të tij, në dy drejtori të përgjithshme.

Nga ana e institucionit raportohet gjithashtu se, dokumenti që e mbështet këtë proces (relacioni) është në fazën e paraqitjes së tij për diskutim dhe miratim në organin kolegjal dhe më tej, për t’u dërguar në Kuvend, duke e lidhur këtë veprim me detyrimin për implementimin e Planit Strategjik të institucionit (2023-2028); Planit të Komunikimit dhe ecurinë e dy Platformave: “Mësojmë nga e kaluara” dhe “Mediateka”.

Komisioneri vlerëson se ristrukturimi i institucionit, sipas kërkesave të ligjit për nëpunësin civil, është një e drejtë e përligjur e institucionit, nëse ai kryhet në përputhje me kërkesat e ligjit që e rregullojnë këtë institut të tij. Por, nga ana tjetër, sjellim në vëmendjen e njësisë përgjegjëse, se në një rast të tillë, nëpërmjet një vendimi të arsyetuar, duhet të vlerësohet situata dhe të reflektohet ajo në planin e rekrutimit, duke e ndryshuar aktin dhe duke hequr nga përmbajtja e tij pozicionin që mendohet se do të riorganizohet, ç'ka duhet të mbahet parasysh në të ardhmen.

Ndërkohë, sa i takon procedurës së ndjekur gjatë administrimit të marrëdhënies së punës në shërbimin civil për punonjësen E Shtino, në lidhje me ndërprerjen e pezullimit dhe emërimin e saj në pozicionin e punës “Drejtor i Përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Trajtimit të Kërkesave”, në Autoritetin për Informim mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit, nga dokumentacioni i administruar rezulton se:

Nëpunësja E. Shtino ka qenë e emëruar në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, pranë Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), nëpërmjet aktit administrativ nr. 101/3, dt. 15.03.2017, të titullarit të institucionit.

Në vijim të marrëdhënies së punësimit në këtë pozicion pune, nëpërmjet informacionit të administruar në përmbajtje të kërkesës së punonjëses në fjalë, (protokolluar me nr. 1190, datë 06.12.2018), njësia përgjegjëse dhe titullari i institucionit është njohur me faktin se ajo është emëruar në pozicionin e punës “Këshilltar Ligjor i Komisionerëve Publikë”, (sipas vendimit nr. 23, datë 04.12.2018, të Komitetit ad hoc të Komisionerëve Publikë).

Pas vlerësimit të rrethanave të rastit, njësia përgjegjëse e institucionit, ka konstatuar shkakun e pezullimit, nëpërmjet Vendimit nr. 1190/1 prot., datë 7.12.2018 “Për pezullimin nga shërbimi civil” dhe në zbatim të nenit 54, pika 1, germa a), të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka vendosur pezullimin nga shërbimi civil për nëpunësen Ermira Shtino.

Më tej, me përfundimin e mandatit të institucioneve të rivlerësimit të organeve të drejtësisë, nëpunësja në fjalë, nëpërmjet shkresës së protokolluar me nr. 1887, datë 06.11.2024, dërguar institucionit, ka njoftuar për zhdukjen e shkakut të pezullimit dhe ka kërkuar rikthimin në shërbimin civil, në pozicionin që ajo mbante përpara pezullimit, ose në rast të pamundësisë për t’u sistemuar në atë pozicion, emërimin në një pozicion tjetër të ngjashëm, në të njëjtën kategori, mbështetur, në pikën 1, të nenit 56, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6, të nenit 29, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet shprehimisht:

“Pas përfundimit të mandatit të institucioneve të rivlerësimit, këshilltari ligjor dhe ekonomik, me pëlqimin e tij/saj, ka të drejtë të emërohet në funksionin ose detyrën publike që kishte para zgjedhjes së tij/saj ose në një vend të përafërt në administratën publike.”

Pasi është vënë në lëvizje nga kërkesja, njësia përgjegjëse, ka analizuar strukturën, organikën dhe vendet të cilat ishin të lira, me qëllim rikthimin dhe emërimin e nëpunëses dhe ka konstatuar pamundësinë për ta rikthyer në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, për shkak se ky pozicion ishte i plotësuar përfundimisht.

Në këto rrethana, nëpërmjet aktit nr. 1887/1 datë 26.11.2024, të Njesisë Përgjegjëse “Vendim për rikthimin në shërbimin civil, për shkak të ligjit”, si dhe aktit nr. 1887/3, datë 30.12.2024, të Sekretarit të Përgjithshëm “Rikthim në shërbimin civil dhe fillimi i marrëdhënieve të punës dhe marrëdhënieve financiare të znj. Ermira Shtino”, është vendosur transferimi i nëpunëses në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Trajtimit të Kërkesave”, në institucionin e Autoritetit për Informim mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), i cili është pozicion i kategorisë së lartë drejtuese.

Këto veprime administrative janë kryer nga subjektet përkatëse, duke u referuar në pikën 1/1, të nenit 56, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se: “Njësia përgjegjëse është e detyruar që në momentin e krijimit të një vendi të lirë në shërbimin civil, t’ia ofrojë fillimisht këtyre nëpunësve civilë, që plotësojnë kriteret përkatëse, duke respektuar në çdo rast shkaqet e përmendura nga neni 48, pika 3, e këtij ligji, i cili në këtë rast zbatohet me ndryshimet përkatëse”, si dhe në mbështetje të kreut II, të Vendimit nr.124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”.

Për sa u analizua më sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e njesisë përgjegjëse të institucionit të AIDSH dhe aktorëve të tjerë në këtë proces, është vepruar drejt duke e rikthyer punonjësen E. Shtino, në një pozicion pune të së njëjtës kategori të shërbimit civil, pasi është konstatuar se ka rënë arsyeja e pezullimit për shkak të ligjit dhe për të finalizuar këtë proces, është vepruar sipas procedurës që kërkon ligji për nëpunësin civil.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 e 25 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të nenit 90, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të informacionit të rregjistruar pranë Komisionerit me nr. 102 prot., datë 30.01.2025, të paraqitur nga nëpunësi

Selami Zalli, me objekt: vlerësimin e ligjshmërisë, gjatë procedurës së ndjekur për plotësimin e pozicionit të punës “*Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Trajtimit të Kërkesave*”, në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), pasi në veprimet e kryera për administrimin e shërbimit civil nga subjektet përkatëse, nuk konstatohen parregullsi në kuptim të zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil dhe arkivimin e çështjes.

2. Të njoftohet për këtë vendim Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish - Sigurimit të Shtetit dhe nëpunësi Selami Zalli.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha